



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par 2 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal Nr.04/L-010 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur e me 29. 07. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoj këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË MES TË KOMUNËS SË GJILANIT DHE KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET , Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Lipjanit .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Lipjanit Nr 1-346-37158, protokolluar më 13.07.2016.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

15Nr. 346-41390
Lipjan me 01. 08. 2016

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesja
Vlora Limani-Hajnuni

